

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përherëshëm i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 29 datë 21 / 12 / 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim “Për miratimin e shpërblimit me rastin e festave të fundit për punonjësit mbështetës pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare Utilitare dhe punonjësve zjarrfikës”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKM-së nr 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, VKB-së nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”, i ndryshuar

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Përmirësimi i pagave dhe i kushteve të punës ndihmon në mbajtjen e personelit të kualifikuar, rritjen e moralit dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Shpërblimi rrit motivimin dhe angazhimin e punonjësve, duke i inkurajuar ata të japin më të mirën në vendin e punës, e përkthyer kjo në shërbim më të mirë ndaj komunitetit. Punonjësit mbështetës kryejnë detyra relativisht të vështira dhe jetike që ndihmojnë në kryerjen e funksionit kryesor të ndërmarrjes dhe shpërblimi është një mënyrë mirënjohjeje për përpjekjen në realizimin më së mirë të detyrave. Shpërblimi i dhënë drejt krijon mjedis pune pozitiv dhe bashkëpunues, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e përgjithshme. Përtej kësaj forma e shpërblimit forcon kulturën e institucionit apo organizatës, ku çdo punonjës, pavarësisht rolit, është i vlerësuar për punën e realizuar. Forma e shpërblimit është një investim në burime njerëzore që sjell përfitime afatgjata të institucionit duke krijuar një mjedis pune më të qëndrueshëm, produktiv dhe të harmonizuar.

Gjatë vitit 2025 punonjësit e mزش-së kanë qenë vazhdimisht të angazhuar në përballimin e situatave emergjente të

zjarreve, përmendim sitatën e muajve të verës ku u dogjën sipërfaqe të mëdha pyje, kullota etj, punonjësit zjarrfikës kanë ardhur në ndihmë edhe në bashkitë fqinje. Përveç kësaj punonjësit zjarrfikës kanë qenë vazhdimisht të angazhuar për ndërhyrje në kushte të vështira atmosferike dhe terreni. Natyra e veçantë dhe rrezikshmëria e këtij shërbimi e bëjnë të domosdoshme vlerësimin jo vetëm moral dhe edhe financiar, veçanërisht në fund të vitit, si element motivues dhe stimulus për vijimësinë e shërbimit cilësor.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKM-së nr 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, VKB-së nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025” i ndryshuar, i ndryshuar, Bashkia Gjirokastrë propozon të përdorimin e fondit të veçantë me qëllim shpërblimin e punonjësve mbështetës pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare Utilitare në masën 10, 000lekë dhe punonjësit e shërbimit zjarrfikës po në masën 10,000 lekë. Burimi i financimit të jetë fondi i veçantë sipas strukturave përkatëse.

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh:

Komisioni i Finances dhe Buxhetit dhe keshilli bashkiak bazuar mbi detyrimet ligjore që e detyrojnë administratën të raportojë si dhe sa herë që keshilli e sheh të nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Punonjësit mbështetës pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare Utilitare dhe punonjësit zjarrfikës, por indirekt edhe komuniteti në teresi.

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik, i mbledhur me datën / 12 / 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. datë 21 / 12 / 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin **“Për miratimin e shpërblimit me rastin e festave të fundit për punonjësit mbështetës pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare Utilitare dhe punonjësve zjarrfikës”**

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit



(emri, mbiemri, firma) Kryetar i Komisionit



(emri, mbiemri, firma) Sekretar i Komisionit

Datë: 21 / 12 / 2025